



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	25.11.2025
Nga:	ZPP Gentiana Qela
PER:	N.N.T KORABI
Lenda :	VENDIM

Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr. 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “N.N.T KORABI” të datës 24.11.2025 kundër njoftimit për kontratë për procedurë të prokurimit me numër 611-25-5498-5-1-11 me titull “REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDERTIMI I TROTUARIT ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK” datës 18.06.2025, Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.N.T KORABI “të datës 24.11.2025 kundër njoftimit për dhenje të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-5498-5-1-1 me titull “REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDERTIMI I TROTUARIT ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK” datës 18.06.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin për dhenje të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik “N.N.T KORABI” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka analizuar pretendimet e juaja ankimore dhe ka vlersuar se pretendimet e paraqitura janë të pabazuara pasi që në kekesen tuaj ju nuk keni argumentuar arsyet për eliminim. Pretendimi në lidhje me inxhinierin është i pabazuar për arsye se inxhinieri në fjalë ka dërguar vazhdimisht emaila në Ak që nuk ka marrëveshje me ju për këtë projekt dhe në për këtë kemi bërë kërkesë për listë të

zeze ne OSHP dhe nuk kemi ende nje pergjigje zyrtare nga OSHP per kete lende , deri ne vendimin e OSHP ju jeni I papergjegjshem per shkak te perdorimit te dokumentacionit pa autorizimin dhe njoftimin e inxhinerit per procedure ne fjale .

OE “ Fer Petroll” eshte eliminuar sipas vendimit te OSHP

Oe “ Aktiv SHPK “ nuk ka bere vazhdimin e validitetit

Ndersa OE I rekomanduar per kontrate eshte I pergjegjshem dhe ka plotesuar te gjitha kerkesat e AK sipas dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate dhe te gjitha pretendimet qe ju keni paraqitur jane te pabazuara disa nga gjetjet e juaja jane plotesuar me kerkesen per sqarime dhe pasi qe ju nuk keni bere qasje gjate rivlersimit nuk e keni komplet dosjen dhe nuk keni mundur te trajtoni ne menyre te drejt .

Kunder ketij vendimi keni te drejt ankese ne OSHP ne afatë prej 10 ditë !

Me respekt !